



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.527/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesuese, Adnan Konushevcu dhe Faton Ademi anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Miranda Lushaj, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal të Gjakovës, ng aradhet e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, dega në Gjakovë, paraqitur kundër Këshillit të Vendvotimit (KVV), për shkak të parregullsive në Vendvotim, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 26.10.2017, mori këtë:

#### V E N D I M

**HUDHET** si e pa rregullt ankesa e Miranda Lushaj, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal të Gjakovës, nga radhet e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, dega në Gjakovë, paraqitur kundër Këshillit të Vendvotimit (KVV), për shkak të parregullsive në Vendvotim, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017,

#### A r s y e t i m

Më datën 25.10.2017, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Miranda Lushaj, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal të Gjakovës, nga radhet e PDK, dega në Gjakovë, me të cilën ka pretenduar se në Qendrat e Votimit si: në Shkollën "Hajdar Dushi" QV 0201C, në Shkollën "Mustafa Bakija" QV 0202C, Shkollën "Yll Morina", QV 0202X, Shkolla "Zekria Rexha" QV 00205C, Shkolla në fshatin Kralan, VV 0206c, fshati Bishtazhin, VV 0223C, fshati Demjan, VV 0213C, fshati Bec, VV 0215C, fshati Sheremetaj 02221C, fshati Piskotë 0223 c dhe fshati Zhabel 0227C i mungojnë votat sepse familjaët e kanë votuar.

Parashtruesja e ankesës kërkon nga PZAP-i të rinumërohen këto Qendra të Votimit.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të rregullësisë së ankesës gjeti se:

#### **Ankesa është e pa rregullt**

PZAP-i, nga shkresat e lëndës vlerësoj se ankesa e parashtruar nga ana e Miranda Lushaj, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal të Gjakovës, nga radhet e PDK, dega në Gjakovë është e parregullt sepse nuk është e nënshkruar nga parashtruesja a ankesës dhe si tillë ankesa nuk i plotëson kushtet sië kërkohen me nenin 5.6 të Rregullës nr.02/2015, të PZAP-it dhe në bazë të nenit 118 të LZP-së ku përcaktohet se: *Ankesat duhet të dorëzohen me shkrim dhe duhet të jenë të nënshkruara nga ankuesi apo në emër të tij nga i autorizuari.*

Prandaj PZAP-i, nuk u lëshua fare në meritat e ankesës, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozita e lartëtheksuara.

Nga arsyet e sipërshënuar e në mbeshtejte të nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr.527/2017 më datën 26.10.2017.

**Kryesuesi i Panelit  
Fejzullah Rexhepi**



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.